VENDIM
Nr. 259, datë 28.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "AGETA" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "BORIE – LURË 1" ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/1 prot., datë 24.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Ageta" sh.p.k., me shkresën nr. 8 prot., datë 17.12.2020, dhe protokolluar në ERE me nr. 1288 prot., datë 21.12.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC "Borie Lurë 1", me vendndodhje në ujërat e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër.

- Shoqëria "Ageta" sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.12.2014, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "Ageta" sh.p.k. rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "f", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat: "a", "b", "c" dhe "d", dhe pika 4.1.4, germat: "a", "b", "c" dhe "d", plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: "a", "b", plotësuar.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (datë 9.4.2022), do t'i kërkohet shoqërisë ta depozitojë në ERE të rifreskuar, një muaj pas rinovimit të afatit të saj.

- Duke qenë se Urdhri mbi vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kullosor, është dokument i cili lidhet me pronësinë shoqëria pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullosor publik të sipërfaqes së përcaktuar më sipër, ta depozitojë atë në ERE.

- Kontrata nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Borie Lurë 1', me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër", e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Ageta" sh.p.k. dhe "Bajrami N" sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe të nenit 5, të "Rregullores për

procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "e" (Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik).

- germa "g" (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti);

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.),

Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5:

- germa c, leja mjedisore,

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Boria Lura 1"; me kapacitet të instaluar 1800 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti